



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 163

**Tiranë – E hënë, 21 shtator 2015**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 734, datë 9.9.2015	Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore..... 11425
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 9.9.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar..... 11426
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 9.9.2015	Për përcaktimin e tarifave të akreditimit dhe për trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit..... 11428
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 738, datë 9.9.2015	Për shpërblimet e anëtarëve të bordit të akreditimit dhe grupeve teknike të punës..... 11430
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 740, datë 9.9.2015	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2009; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 359, datë 4.5.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 900, datë 12.12.2012; nr. 490, datë 18.6.2013; nr. 686, datë 16.8.2013; nr. 713, datë 29.10.2014; nr. 42, datë 21.1.2015; nr. 474, datë 3.6.2015; nr. 615, datë 7.7.2015, të ndryshuara, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale..... 11431

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 741, datë 9.9.2015	Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare.....	11436
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 743, datë 9.9.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 456, datë 27.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i Amfiteatrit të Durrësit”” .....	11443
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 22/1, datë 17.9.2015	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 22, datë 31.7.2015 “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja të transportit të udhëtarëve, të më shumë se 20 personave, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, si dhe të mjeteve të transportit të mallrave me ngarkesë apo pa ngarkesë”.....	11444
Urdhër i ministrit të Financave nr. 36, datë 12.5.2015	Për kufizimin e sasive të karburantit që gjendet në serbatorët e zakonshëm dhe depozitat e posaçme të automjeteve tregtare dhe në serbatorët e lëvizshëm të automjeteve private.....	11444

**VENDIM****Nr. 734, datë 9.9.2015****PËR RREGULLIMIN E VEPRIMTARISË  
ME JASHTË TË ADMINISTRATËS  
SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 23/2015, datë 19.3.2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrinë, institucionet shtetërore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, institucionet e tjera të administratës shtetërore dhe organet e pushtetit vendor e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me jashtë në lidhje e bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, me qëllim garantimin e kësaj veprimtarie, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me interesin kombëtar.

2. Ministrat e zëvendësministrat, drejtuesit e institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, drejtuesit e institucioneve të tjera të administratës shtetërore dhe të organeve të pushtetit vendor, në deklaratat verbale e të shkruara dhe intervistat për probleme të rëndësishme të marrëdhënieve me jashtë duhet të jenë në përputhje me programin e qeverisë për politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë. Për çështje të politikës së jashtme të një rëndësie të veçantë, funksionarët e lartpërmendur, në deklaratimet e tyre publike, duhet të konsultohen, paraprakisht, me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

3. Ministrat e zëvendësministrat, drejtuesit e institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, të institucioneve të tjera të administratës shtetërore dhe të organeve të pushtetit vendor, në korrespondencën me ambasadorë e përfaqësues të tjerë të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, për çështje me karakter politik ose me rëndësi për marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me shtetet e tjera apo organizatat ndërkombëtare, duhet të njoftojnë, paraprakisht, Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila jep, me shkrim, mendimin e saj për qëndrimin që duhet mbajtur.

4. Ministrat e zëvendësministrat, drejtuesit e institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, të institucioneve të tjera të

administratës shtetërore dhe të organeve të pushtetit vendor, për veprimtaritë ku marrin pjesë dhe bisedimet që realizojnë me personalitete të huaja, brenda dhe jashtë vendit, të dërgojnë, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e përfundimit të veprimtarisë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Kryeministri, një relacion. Relacioni duhet të përmbajë të dhënat për qëllimin dhe objektin e veprimtarisë, për ecurinë e bisedimeve dhe për rekomandimet përkatëse për çështjet e diskutuara. Për çështje të rëndësishme ose urgjente, Ministria e Punëve të Jashtme mund të kërkojë dorëzimin e relacionit edhe brenda një afati më të shkurtër.

5. Ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, institucionet e tjera të administratës shtetërore dhe organet e pushtetit vendor, komunikojnë zyrtarisht me misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme. Institucionet e lartpërmendura komunikojnë drejtpërdrejt me përfaqësuesit e tyre në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për çështje brenda fushës së përgjegjësisë së tyre, duke vënë në dijeni kreun e misionit diplomatik.

6. Ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, institucionet e tjera të administratës shtetërore dhe organet e pushtetit vendor e realizojnë korrespondencën e tyre zyrtare me misionet diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

7. Vizitat zyrtare dhe të punës të anëtarëve të Këshillit të Ministrave jashtë shtetit zhvillohen me miratimin e Kryeministrit, pasi ministri i Punëve të Jashtme të jetë shprehur me shkrim. Kërkesa për miratimin e vizitës i drejtohet, njëkohësisht, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme. Anëtarët e Këshillit të Ministrave, brenda çdo tremujori, paraqesin me shkrim, pranë Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme, planin e vizitave jashtë vendit për tremujorin në vazhdim.

8. Në rastin e vizitave urgjente të punës, të paparashikuara, të anëtarëve të Këshillit të Ministrave, miratimi u jepet drejtpërdrejt nga Kryeministri, mbështetur në kërkesën e tyre. Ministria e Punëve të Jashtme vihet në dijeni, në çdo rast, për realizimin e këtyre vizitave.



9. Drejtuesit e institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, të institucioneve të tjera të administratës shtetërore dhe të organeve të pushtetit vendor nuk mund të pranojnë ose të refuzojnë ftesa zyrtare nga homologët e tyre si dhe nuk mund të dërgojnë ftesa zyrtare, pa u këshilluar më parë me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

10. Ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, institucionet e tjera të administratës shtetërore dhe organet e pushtetit vendor, në ushtrimin e veprimtarisë me jashtë, kanë për detyrë:

a) të njoftojnë, menjëherë, Ministrinë e Punëve të Jashtme për çështjet në fushën e marrëdhënieve me jashtë që trajtohen gjatë takimeve të drejtuesve të institucionit me përfaqësues të trupit diplomatik të shteteve dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, apo në letrat dhe mesazhet që autoritete të huaja i dërgojnë drejtuesit të institucionit;

b) të organizojnë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, takimet e drejtuesit të institucionit me homologët e tij, brenda dhe jashtë vendit;

c) të organizojnë protokollin e takimeve të drejtuesit të institucionit me delegacionet e huaja apo me përfaqësues të trupit diplomatik, të akredituar në Republikën e Shqipërisë;

ç) të njoftojnë Ministrinë e Punëve të Jashtme, çdo tre muaj, për planin e vizitave të delegacioneve të kryesuara nga drejtuesi i institucionit apo nga zyrtarë të lartë, si dhe të delegacioneve të huaja që do të vizitojnë Republikën e Shqipërisë;

d) të dërgojnë çdo tre muaj në Ministrinë e Punëve të Jashtme një raport për të gjitha veprimtaritë me jashtë të institucionit, duke përfshirë edhe ecurinë e marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe;

dh) të dërgojnë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të dhëna dhe raportime, sipas kërkesave e afateve, për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

11. Ministria e Punëve të Jashtme ka për detyrë:

a) të njoftojë ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, institucionet e tjera të administratës shtetërore dhe organet e pushtetit vendor për veprimtaritë e zhvillimet ndërkombëtare, si dhe për rezultatet e takimeve e të konsultimeve diplomatike për çështje që lidhen me fushën e përgjegjesisë së tyre;

b) të ndihmojë me materiale dhe brenda përgjegjesisë së saj, të këshillojë për përgatitjen e vizitave e të takimeve të planifikuara të ministrive, institucioneve qendrore dhe organeve të pushtetit vendor;

c) të ofrojë ndihmën e nevojshme ligjore në procesin e lidhjes së marrëveshjeve ndër-kombëtare nga ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit e të ministrave, institucionet e tjera të administratës shtetërore dhe organet e pushtetit vendor, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) t'u komunikojë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë kërkesat që vijnë nga institucionet e ndryshme, të cilat i gjykon të arsyeshme;

d) të organizojë takime me drejtuesit e strukturave që zhvillojnë veprimtari me jashtë të ministrive dhe institucioneve qendrore me qëllim informimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së tyre;

dh) të orientojë qëndrimet që këto organe duhet të mbajnë brenda sferës së veprimtarisë së tyre për çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me jashtë.

12. Vendimi nr. 228, datë 23.4.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për veprimtarinë me jashtë të administratës shtetërore", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**VENDIM**  
Nr. 736, datë 9.9.2015

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR  
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË  
NIVELEVE TË PAGAVE TË  
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,  
ZËVENDËSMINISTRIT DHE  
NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË  
KRYEMINISTRIN, APARATET E  
MINISTRIVE TË LINJËS,  
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT,  
KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E  
PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE  
TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË  
VARËSI TË KRYEMINISTRIT,**



## INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1/3 bëhen shtesat e mëposhtme:

i) Në shkronjën “b” shtohet emërtesa “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura”;

ii) Në shkronjën “c” shtohen emërtesat “Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor” dhe “Inspektorati Shtetëror i Ujërave”;

b) Në lidhjen nr. 3, që përmendet në pikën 3, të vendimit në fuqi, në nënndarjen “Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, kategoria e pagës për punonjësit e pozicionit “inspektor” bëhet III-a;

c) Pika 4/1 riformulohet, si më poshtë vijon:

“4/1. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët e drejtorive”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i Shkencave/Master Profesional /Bachelor” apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “Informatikë”, “Inxhinieri telekomunikacioni”, “Teknologji informacioni” apo “Shkenca kompjuterike”, në masën:

- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore, në institucionet e përcaktuara në pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3, të këtij

vendimi.

Aplikimi i kësaj shtese bëhet vetëm në rastet kur institucionet kanë krijuar baza të të dhënave shtetërore, të miratuara e të regjistruara pranë Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi.

- 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për nëpunësit e tjerë të strukturave të TIK, të institucioneve të përcaktuara në pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3, të këtij vendimi, të cilët nuk punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.

- 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj për nëpunësit e strukturave të TIK të institucioneve rajonale /vendore.

Zbatimi i shtesave si më sipër për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, bazuar në përshkrimin e pozicionit të punës.

Përfshihen nga ky parashikim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të vëre në dispozicion të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave listën e përditësuar të institucioneve që kanë krijuar baza të të dhënave shtetërore dhe janë regjistruar si të tilla pranë këtij institucioni sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast se për institucionet ku janë të punësuar nëpunësit në pozicionet e sipërpërmendura parashikohen shtesa të tjera për kushte pune, nëpunësit e strukturave të TIK do të zgjedhin ndërmjet dy shtesave, por, në asnjë rast, nuk mund t'i përfitojnë të dyja shtesat.”

ç) Në lidhjen nr. 5, që përmendet në pikën 5, pas emërtesës “Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik” shtohet emërtesa “Kordinator në Institutin e Statistikave (INSTAT)”.

2. Nëpunësit/punonjësit e administratave rajonale të zonave të mbrojtura do të vazhdojnë të paguhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të shërbimit pyjor.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2015, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2015 dhe për Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe administratat rajonale të zonave të



mbrojtura, si dhe Inspektoratin Shtetëror të Ujërave i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë nga data 1 janar 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 737, datë 9.9.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË AKREDITIMIT DHE PËR TRAJNIMET E ORGANIZUARA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2, 3 e 8, të nenit 5, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e tarifave për mbulimin e kostove që lidhen me akreditimin në Republikën e Shqipërisë ku përfshihen:

- a) kërkesa për akreditim fillestar;
- b) kërkesa për zgjerim të fushës së akreditimit;
- c) kërkesa për riakreditim;
- ç) tarifat administrative;
- d) tarifat për vlerësimin për ditë/për vlerësues;
- dh) tarifat për dhënien e certifikatës;
- e) tarifat vjetore;

ë) tarifat për ndryshimin e certifikatës dhe ndryshimin e fushës së akreditimit.

2. Në tarifat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” përfshihen kostot për shqyrtimin e aplikimeve dhe kryerjen e aktiviteteve përgatitore për fillimin e procedurave të akreditimit fillestar, procedurës së zgjerimit të fushës së akreditimit dhe procedurës së riakreditimit.

3. Në tarifat administrative përfshihen kostot për përgatitjen e kontratës, lëshimin e dokumenteve nga DPA-ja e takimet e shkurtra informative.

4. Në tarifat për vlerësimin për ditë/për vlerësues përfshihen kostot për aktivitetet për

organizimin e paravlerësimit/vlerësimit/mbikëqyrjes/riakreditimit, shqyrtimit të dokumentacionit, organizimin e vizitës paravlerësuese/vlerësuese/mbikëqyrëse dhe riakredituese, hartimin e raportit të vlerësimit dhe zgjidhjes së moskonformiteteve. Kostoja e paravlerësimit llogaritet vetëm për një ditë vlerësim dhe për një kryevlerësues. Kostoja për vlerësimin përcaktohet për çdo rast të akreditimit fillestar, riakreditimit, zgjerimit të fushës së akreditimit, mbikëqyrjeve të rregullta dhe atyre shtesë, në varësi nga numri total i ditëve të vlerësimit dhe numri i vlerësuesve. Numri total i ditëve të vlerësimit varet nga fusha e aplikimit, numri i metodave ose procedurave dhe fusha e aktiviteteve përgatitore. Kostot e vizitave shtesë paguhën nga organet e vlerësimit të konformitetit aplikues ose të akredituar nëse moskonformitetet që janë përcaktuar janë shkak për vizitën shtesë.

5. Në tarifën për certifikatën e akreditimit përfshihen kostot për përgatitjen e certifikatës, fushës së akreditimit, përgatitjen e CD me simbolin e akreditimit, lëshimin e procedurave për përdorimin e simbolit dhe për të drejtat dhe detyrimet e organit të vlerësimit të konformitetit të akredituar.

6. Në tarifën vjetore përfshihen kostot për përdorimin e simbolit të akreditimit, lajmërimin e organit të vlerësimit të konformitetit të akredituar në lidhje me të rejat për akreditimin në përgjithësi dhe ato në DPA në veçanti, si dhe lajmërimin për pjesëmarrje në krahasimet ndërlaboratorike.

7. Në tarifat për ndryshimin e certifikatës dhe ndryshimin e fushës së akreditimit përfshihen kostot për rishikimin e certifikatës dhe fushës së akreditimit në rastet e ndryshimit të standardit, ndryshimit të adresës së organit të vlerësimit të konformitetit, emërimit të organit të vlerësimit të konformitetit, zgjerimit dhe reduktimit të akreditimit.

8. Tarifa për vlerësim për kryevlerësuesit dhe ekspertët teknikë është e njëjtë me atë të vlerësuesit.

9. Tarifa për vlerësimin e dhënë në shkronjën “d”, të pikës 1, zbatohet vetëm për vlerësuesit shqiptarë. Për vlerësuesit e huaj, tarifa e vlerësimit është sipas vendit të origjinës.

10. Shërbimet, që kryhen jashtë ambienteve të DPA-së për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit, të tilla si shpenzimet e udhëtimit



(transporti), akomodimit dhe dietave, mbulohen nga aplikuesi për akreditim ose organi i akredituar.

11. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe dietave për vlerësuesit vendas përcaktohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

12. Për çdo proces vlerësimi, numri i ditëve, numri i vlerësuesve dhe ekspertëve të nevojshëm përcaktohet me propozimin e kryevlerësuesit dhe me miratimin e drejtorit të Departamentit të Akreditimit në DPA.

13. Normat për shërbimet e ofruara nga DPA-ja (paravlerësimi, vlerësimi fillestar, vëzhgimi, zgjerimi, mbikëqyrja dhe rivlerësimi) llogariten sipas tarifave për vlerësimin në bazë të dispozitave të këtij vendimi dhe përcaktohen nga drejtori i Departamentit të Akreditimit.

14. Kompensimi i shpenzimeve sipas këtij vendimi paguhet në llogarinë e DPA-së.

15. Mbulimi i shpenzimeve për pjesëmarrje në krahasime laboratorike ndërkombëtare apo në programet e tjera për testet e zotësisë së organit të akredituar me kërkesë të DPA-së mbulohen nga organi i akredituar.

16. Shpenzimet për shërbimet për mbikëqyrje shtesë të lajmëruara ose të palajmëruara llogariten në kushte të barabarta si në rastet për mbikëqyrje të rregullta.

17. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe dietave për vlerësuesit e huaj paguhen nga aplikuesi ose organi i akredituar. DPA-ja përpiqet që shpenzimet e udhëtimit të jenë sa më të ulëta. Shpenzimet për udhëtim brenda vendit, akomodim dhe dieta llogariten sipas legjislacionit në fuqi.

18. Shpenzimet e vlerësimit të kryera nga një organizëm akreditues i huaj në bazë të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e

organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, llogariten sipas vendit të origjinës dhe me marrëveshje midis DPA-së dhe organizmit akreditues të huaj.

19. Shpenzimet e vlerësimit të DPA-së, kur ajo operon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në bazë të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohen sipas vendimit nr. 870, datë 14.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Në këtë rast, tarifa e vlerësimit për ditë/për vlerësues është e njëjtë me atë të pikës 5, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

20. DPA-ja organizon trajnime për palët e treta. Tarifa për trajnim përfshin shpenzimet për pjesëmarrjen në trajnim, materialet e trajnimit, certifikatën e trajnimit. Tarifa për ditë trajnimi është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë dhe tarifa për certifikatën e trajnimit është 1 000 (një mijë) lekë. Tarifat për trajnimet e organizuara nga DPA-ja aplikohen pas datës 1 janar 2016.

21. Tarifat për akreditimin janë sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

22. Kontratat e lidhura ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe organeve të vlerësimit të konformitetit para hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbeten të vlefshme deri në përfundimin e rregullt të afatit të përcaktuar në to.

23. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

### Shtojca 1 Tarifat e shërbimit të DPA-së

Nr.	Përshkrim	Mënyra e pagesës	Lekë
1	Aplikimi për akreditim fillestar	Tarifa paguhet me depozitimin e aplikimit në sekretarinë e DPA-së.	2.500
2	Aplikimi për zgjerim të fushës së akreditimit	Tarifa paguhet me depozitimin e aplikimit në sekretarinë e DPA-së.	2.000
3	Aplikimi për riakreditim	Tarifa paguhet me depozitimin e aplikimit në sekretarinë e DPA-së.	1.500
4	Tarifa administrative	Tarifa paguhet me nënshkrimin e kontratës.	5.000



5	Tarifa e vlerësimit për ditë/për vlerësues	80% e tarifës paguhet para vizitës dhe 20% e tarifës paguhet pas kryerjes së veprimeve korigjuese nga ovk-ja.	16.000
6	Tarifa e certifikatës	Tarifa paguhet kur merret vendimi për akreditim.	10.000
7	Tarifa për ndryshim certifikatë dhe fushe të akreditimit	Tarifa paguhet kur ndryshohet certifikata dhe fusha e akreditimit.	3.000
8	Tarifa vjetore për laboratorët testues/kalibrues/mjekësorë - kur numri i metodave të akredituara është nga 1- 20 - kur numri i metodave të akredituara është nga 21- 100 - kur numri i metodave të akredituara është mbi 100	Tarifa paguhet në përfundim të vitit të parë të akreditimit dhe në çdo vit pasardhës në të njëjtën datë.	- 23.000 - 46.000 - 95.000
8/1	Tarifa vjetore për trupat inspektues - -deri në 10 fusha inspektimi - -mbi 10 fusha inspektimi	Tarifa paguhet në përfundim të vitit të parë të akreditimit dhe në çdo vit pasardhës në të njëjtën datë.	- 25.000 - 50.000
8/2	Tarifa vjetore për trupat certifikues të produkteve -deri ne 10 produkte/grup produkte të akredituara -mbi 10 produkte/grup produkte të akredituara	Tarifa paguhet në përfundim të vitit të parë të akreditimit dhe në çdo vit pasardhës në të njëjtën datë.	- 25.000 - 50.000
8/3	Tarifa vjetore për trupa certifikues të sistemeve të menaxhimit --deri në 10 fusha të sektorëve industrial dhe tregtar --mbi 10 fusha të sektorëve industrial dhe tregtar	Tarifa paguhet në përfundim të vitit të parë të akreditimit dhe në çdo vit pasardhës në të njëjtën datë.	- 25.000 - 50.000
8/4	Tarifa vjetore për trupat certifikues të personit -deri në 10 fusha -mbi 10 fusha	Tarifa paguhet në përfundim të vitit të parë të akreditimit dhe në çdo vit pasardhës në të njëjtën datë.	- 25.000 - 50.000

**VENDIM****Nr. 738, datë 9.9.2015****PËR SHPËRBLIMET E ANËTARËVE TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE GRUPEVE TEKNIKE TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 13, e 11, pika 3, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Masa e shpërblimit për anëtarët e grupeve teknike të punës për çdo pjesëmarrje është 3 000 (tre mijë) lekë dhe kryhet në fund të vitit financiar.

2. Masa e shpërblimit për anëtarët e Bordit të Akreditimit për çdo pjesëmarrje është 5 000 (pesë mijë) lekë dhe kryhet në fund të vitit financiar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2016.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



**VENDIM**

Nr. 740, datë 9.9.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET  
E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.100,  
DATË 27.1.2009; NR. 450, DATË 6.5.2009;  
NR. 611, DATË 11.6.2009; NR. 677, DATË  
18.6.2009; NR. 706, DATË 23.6.2009; NR.  
805, DATË 22.7.2009; NR. 1038, DATË  
14.10.2009; NR. 549, DATË 7.7.2010; NR.  
646, DATË 28.7.2009; NR. 118, DATË  
17.2.2011; NR. 359, DATË 4.5.2011; NR. 513,  
DATË 1.8.2012; NR. 900, DATË 12.12.2012;  
NR. 490, DATË 18.6.2013; NR. 686, DATË  
16.8.2013; NR. 713, DATË 29.10.2014; NR. 42,  
DATË 21.1.2015; NR. 474, DATË 3.6.2015;  
NR. 615, DATË 7.7.2015, TË  
NDRYSHUARA, PËR MIRATIMIN E  
KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA  
PARCELAVE NDËRTIMORE NË FAVOR  
TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE  
INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimet e Këshillit të Ministrave NR. 100, datë 27.1.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009, nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2009; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 359, datë 4.5.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 900, datë 12.12.2012; nr. 490, datë 18.6.2013; nr. 686, datë 16.8.2013; nr. 713, datë 29.10.2014; nr. 42, datë 21.1.2015; nr. 474, datë 3.6.2015; dhe nr. 615, datë 7.7.2015, të ndryshuara, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Gjeneralitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 4/536, 33/383, 33/384, 33/355, 33/351, 33/352, 33/359, 33/367, 33/354,

33/374, 33/376, 33/423, 33/370, 33/372, 33/380 dhe 33/381, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana 1 dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes C, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

2. Gjeneralitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 4/619, 4/620, 3/564 dhe 4/363, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 1, të jenë sipas lidhjes F, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Gjeneralitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 2/596, 11/368, 2/154, 2/155, 2/140, 2/153, 2/131, 2/130, 2/129, 2/128, 2/127, 11/120, 2/138, 2/121, 2/137, 2/135, 2/133, 2/124, 11/129 dhe 2/136, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana 1 dhe Vlorë, të jenë sipas lidhjes G, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Gjeneralitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 8/427, 2/309 dhe 7/210, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 1, të jenë sipas lidhjes H, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Gjeneralitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 400/543, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 1, të jenë sipas lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Gjeneralitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 33/390, 33/427, 33/431, 33/435, 33/396, 33/395 dhe 33/432, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë, të jenë sipas lidhjes J, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Gjeneralitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 18/30, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat, të jenë sipas lidhjes K, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Gjeneralitetet e poseduesve të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 11/435 dhe 2/574, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana 2 dhe Berat, të jenë sipas lidhjes Q, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Gjeneralitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 400/1572 dhe 8/493, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana 2 dhe Tirana 1, të jenë sipas lidhjes R, që i bashkëlidhet këtij vendimi.



10. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 22/252 dhe 2/548, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tërana 1 dhe Tërana 2, të jenë sipas lidhjes S, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 6/131, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, të jenë sipas lidhjes T, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 28/157 dhe 8/1074, në drejtoritë e ALUIZNI-t Kukës dhe Shkodër, të jenë sipas lidhjes V, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

13. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 6/325, 6/326, 5/417 dhe 5/418, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 2, të jenë sipas lidhjes X, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 33/405, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë, të jenë sipas lidhjes AC, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

15. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 5/850, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 2, të jenë sipas lidhjes AE, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

16. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 4/192 dhe 6/83, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Kukës, të jenë sipas lidhjes AG, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

17. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 1/12, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Kukës, të jenë sipas lidhjes AH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

18. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 5/324, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 2, të jenë sipas lidhjes AJ, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

19. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë, për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 7/272, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, të jenë sipas lidhjes AK, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama



Republika e Shqipërisë  
Ministria e Zhvillimit Urban

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale

LISTA EMËRORE SIPAS DREJTORIVE RAJONALE PËR KORRIGJIM

LIDHJA C									
NR. RENDOR	DREJTORIA	KORRIGJIMI	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	NR. PROTOKOLLI VETËDEKLARIMIT PËR LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	SIPËRFAQJA E PARCELËS NDËRTIMORE PËR KALIM PRONËSIE (m <sup>2</sup> )
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
1	Tërana 1	ishte	BASHKIM	NOVRUZ	ZAIMAJ	961	8340	4/536	196.3
		bëhet	BASHKIM	NOVRUS	ZAIMAJ	961	8340	4/536	325.4
			GENCI	NOVRUS	ZAIMAJ				
2	Vlora	ishte	SELAM	MYSLYM	ZYLËFTARI	930/5	8605	33/383	482.0
		bëhet	ANULOHET						



3	Vlora	ishte	RRAPI	SOTIR	ILIA	2223/5	8605	33/384	504.0
		bëhet				ANULOHET			
4	Vlora	ishte	ZENEL	QAMIL	QAMILI	1927/5	8605	33/355	472.0
		bëhet				ANULOHET			
5	Vlora	ishte	ASTRIT	LAVDOSH	HITAJ	1580/5	8605	33/351	520.0
		bëhet				ANULOHET			
6	Vlora	ishte	ALBERT	HAJRI	HITAJ	1579/5	8605	33/352	516.0
		bëhet				ANULOHET			
7	Vlora	ishte	RUZHDI	ISLAM	SHUAJPI	2714/5	8605	33/359	296.5
		bëhet				ANULOHET			
8	Vlora	ishte	ARJAN	ISA	DRIZA	2485/5	8605	33/367	440.0
		bëhet				ANULOHET			
9	Vlora	ishte	KRISTOFOR	BEGO	BEGAJ	2521/5	8605	33/354	232.0
		bëhet				ANULOHET			
10	Vlora	ishte	ALFRED	FLAMUR	LULE	2394/5	8605	33/374	355.0
		bëhet				ANULOHET			
11	Vlora	ishte	FLAMUR	HAXHI	LULE	2393/5	8605	33/376	227.0
		bëhet				ANULOHET			
12	Vlora	ishte	ARBEM	HAXHI	LULE	288/5/80	8605	33/423	189.6
		bëhet				ANULOHET			
13	Vlora	ishte	PETREF	QAZIM	BRAKA	2327/5	8605	33/370	476.0
		bëhet				ANULOHET			
14	Vlora	ishte	FATMIR	QAZIM	DRIZA	1861/5	8605	33/372	503.0
		bëhet				ANULOHET			
15	Vlora	ishte	EMIN	SAFET	SHEHU	2410/5	8605	33/380	508.0
		bëhet				ANULOHET			
16	Vlora	ishte	HSNI	EMIN	SHEHU	2503/5	8605	33/381	489.0
		bëhet				ANULOHET			
<b>LIDHJA F</b>									
17	Tirana 1	ishte	HAFUZ	JONUZ	MUCA	535	8340	4/619	104.3
		ishte	BUJAR	JONUZ	MUCA	518	8340	4/620	138.2
		bëhet	HAFUS	JONUZ	MUCA	535	8340	4/620	138.2
		bëhet	BUJAR	JONUZ	MUCA	518	8340	4/619	104.3
18	Tirana 1	ishte	LEK	MARTIN	LEPEJA	3453	8310	3/564	321.8
		bëhet	LEKE	MARTIN	LEPEJA	3453, 777	8310	3/564	433.8
19	Tirana 1	ishte	GENC	HYSEN	ÇELA	2409/	8240	4/363	300.1
		bëhet	GENC	HYSEN	ÇELA				
		bëhet	TASIM	HYSEN	ÇELA	2409, 473	8240	4/363	420
<b>LIDHJA G</b>									
20	Tirana 1	ishte	ALBERT	XHEVAIR	DASHI	66	8220	2/596	257.7
		bëhet	ALBERT	XHEVAIR	DASHI	66	8220	2/596	276.6
21	Tirana 1	ishte	FATIHO	DERVISH	LAZI	1232	8310	11/368	102.7
		bëhet	FATIHO	DERVISH	LAZI	1241	8310	11/368	288
22	Vlora	ishte	KAJMAK	MIFTAR	MALAJ	331/5	8605	2/154	500.0
		bëhet				ANULOHET			
23	Vlora	ishte	NIKO	SHEME	DHAMO	1357/5	8605	2/155	500.0
		bëhet				ANULOHET			
24	Vlora	ishte	NOVRUZ	BARJAM	TAFA	1766/5	8605	2/140	327.2
		bëhet				ANULOHET			
25	Vlora	ishte	MERUSHE	KAMBER	TOSKA	1650/5	8605	2/153	403.0
		bëhet				ANULOHET			
26	Vlora	ishte	SAMIT	LATIF	MUSAKU	1129/5	8605	2/131	280.3
		bëhet				ANULOHET			
27	Vlora	ishte	VALENTINA	HETEM	MUSAKU	1130/5	8605	2/130	350.8
		bëhet				ANULOHET			
28	Vlora	ishte	BASHKIM	JANUS	KASAJ	705/5	8605	2/129	301.0
		bëhet				ANULOHET			
29	Vlora	ishte	MAKE	DANE	HOXHA	2001/5	8605	2/128	225.1
		bëhet				ANULOHET			
30	Vlora	ishte	SABRI	BEQIR	RAMAJ	1986/5	8605	2/127	342.6
		bëhet				ANULOHET			
31	Vlora	ishte	RAMADAN	SHABAN	MOLISHTARI	2665/5	8605	11/120	332.6
		bëhet				ANULOHET			
32	Vlora	ishte	HAKI	LUTA	HAXHIRAJ	2785/5	8605	2/138	500.0
		bëhet				ANULOHET			
33	Vlora	ishte	BESIM	QEMAL	XHEMAJ	1607/5	8605	2/121	500.0
		bëhet				ANULOHET			
34	Vlora	ishte	ADEM	VERO	VERAJ	1654/5	8605	2/137	500.0
		bëhet				ANULOHET			
35	Vlora	ishte	ELHAM	HAXHI	GJOLEKAJ	2431/5	8605	2/135	301.0
		bëhet				ANULOHET			
36	Vlora	ishte	SAMIT	DULE	DURAJ	2059/5	8605	2/133	107.5
		bëhet				ANULOHET			
37	Vlora	ishte	MEÇO	FASLLI	HYSAJ	1479/5	8605	2/124	360.9
		bëhet				ANULOHET			
38	Vlora	ishte	FATMIR	XHEVAIR	TOSKA	2967/5	8605	11/129	334.4
		bëhet				ANULOHET			
39	Vlora	ishte	RENATO	HAXHI	GJOLEKAJ	2433/5	8605	2/136	319.2



		bëhet	ANULOHET						
<b>LIDHJA H</b>									
40	Tirana 1	ishte	BRUNILDA	RAMADAN	KULLOJKA	743	8180	8/427	109.3
		bëhet	BRUNILDA	RAMADAN	KULLOJKA	743	8180	8/427	149
41	Tirana 1	ishte	NDRIÇIM	RESHIT	SALLAKU	1005	8120	2/309	300.3
		bëhet	NDRIÇIM	RESHIT	SALLAKU	1005	8120	2/309	378.6
42	Tirana 1	ishte	GEZIM	RAKIP	COBAJ	1534/	8310	7/210	333.7
		bëhet	GEZIM	RAKIP	COBAJ	4295	8310	7/210	416.3
<b>LIDHJA I</b>									
43	Tirana 1	ishte	SADIK	MET	RAMI	208	3266	400/543	236
		bëhet	SADIK	MEHMET	RAMI	208	3266	12/543	318
<b>LIDHJA J</b>									
44	Vlora	ishte	REMZI	FAIK	KASAJ	1894/5	8605	33/390	336.3
		bëhet	ANULOHET						
45	Vlora	ishte	FADIL	RAMO	DINE	2111/5	8605	33/427	237.4
		bëhet	ANULOHET						
46	Vlora	ishte	AGIM	SHEFQET	MUÇAJ	2679/5	8605	33/431	500.0
		bëhet	ANULOHET						
47	Vlora	ishte	HALO	SHUAIP	KAMBERAJ	1679/5	8605	33/435	405.1
		bëhet	ANULOHET						
48	Vlora	ishte	XHAFER	ISMAIL	SHUAUPI	2401/5	8605	33/396	500.0
		bëhet	ANULOHET						
49	Vlora	ishte	IZET	ISMAIL	SHUAUPI	2210/5	8605	33/395	408.0
		bëhet	ANULOHET						
50	Vlora	ishte	PANDELI	KORAQ	MEHMETI	2882/5	8605	33/432	283.6
		bëhet	ANULOHET						
<b>LIDHJA K</b>									
51	Berat	ishte	Bektash Miri	Abaz	Mato	1053	8501	18/30	310
		bëhet	Bektash Miri	Abaz	Mato	1053	8501	18/30	437
<b>LIDHJA Q</b>									
52	Berat	ishte	BIRBIL	SAFET	HOXHA	1370	8501	11/435	37.4
		bëhet	BIRBIL	SAFET	HOXHA	1370	8501	11/435	73.4
53	Tirana 2	ishte	AGRON	KOVI	XOXA	921	8270	2/574	10.35
			ELI	NASIP	XOXA				
			BASHKIM	ISLAM	JASHARLLARI				
			MARIE	NIKOLLA	SHEGANI				
		bëhet	MERITA	ABDI	DOMI	921	8270	2/574	35.60
			AGRON	KOVI	XOXA				
			ELI	NASIP	XOXA				
			BASHKIM	ASLLAN	JASHARLLARI				
MARIE	NIKOLLA	SHEGANI							
MERITA	ABDI	DOMI							
<b>LIDHJA R</b>									
54	Tirana 1	ishte	GEZIM	RUSTEM	BRAHJA	182	3266	400/1572	384
		bëhet	RUSTEM	MUSA	BRAHJA	251	3266	400/1572	384
55	Tirana 2	ishte	ASKERIM	SHYQYRI	MUÇA	6034	8310	8/493	36.2
			SALI	QAZIM	ROÇI				
			DRITAN	ABDYL	RIZVANI				
			FERDINANT	FRROK	CARA				
		bëhet	NEXHMIJE	MEHMET	ALLA	6034	8310	8/493	54.3
			ERION	PJETER	KAÇORRI				
			ASKERIM	SHYQYEI	MUÇA				
			SALI	QAZIM	ROÇI				
DRITAN	ABDYL	RIZVANI							
FERDINANT	FRROK	CARA							
NEXHMIJE	MEHMET	ALLA							
ERION	PJETER	KAÇORRI							
<b>LIDHJA S</b>									
56	Fier	ishte	TOMORR	MUHAMET	TELHA	632	8571	22/252	140
		bëhet	TOMORR	MUHAMET	TELHA	ANULOHET			
57	Tirana 2	ishte	MAKSIM	ALI	HOXHA	612	8270	2/548	33.69
			RUDI	ANDREA	IKONOMI				
			ERVEHE	ELMAS	BAKAJ				
			CFETAN	ZAFIR	MAZNIKU				
		bëhet	LEONARD	KOL	SIMONI	612	8270	2/548	33.69
			MAKSIM	ALI	HOXHA				
			RUDI	ANDREA	IKONOMI				
			ERVEHE	ELMAS	BAKAJ				
CFETAN	ZAFIR	MANZIKU							
LEONARD	KOL	SIMONI							
ELISABETA	TOM	SIMONI							
GJERGJ	KOL	SIMONI							



LIDHJA T									
58	Tirana 1	ishte	SAKO	ZENEL	SAKOLLARI	2761	8230	6/131	122.6
			PATRIOT	ZENEL	SAKOLLARI				
		bëhet	SAKO	ZENEL	SAKOLLARI	2761	8230	6/131	400
			PATRIOT	ZENEL	SAKOLLARI				
LIDHJA V									
59	Kukes	ishte	BRAHIM	FEJZ	BYTYÇI	5/02	2315	28/157	21.88
			ISMAIL	OSMAN	SHAHU				
		bëhet	BRAHIM	FEJZ	BYTYÇI	5/02	2315	28/157	21.88
			ISMAIL	OSMAN	SHAHU				
60	Shkoder	ishte	MUHAMET	HALIT	HUTI	217	8591	8/1074	73.5
		bëhet	MUHAMET	HALIT	HUTI	217	8591	8/1074	236.4
LIDHJA X									
61	Tirana 2	ishte	DASHNOR	MALUSH	MALUSHI	297	8140	6/325	49.1
			ASQERIM	AVDYL	SADIKU				
		bëhet	RESHAT	RAIT	MULLAHAJ	297	8140	6/326	26.0
			DASHNOR	MALUSH	MALUSHI				
62	Tirana 2	ishte	ASQERIM	AVDYL	SADIKU	297	8140	6/326	22.4
			RESHAT	RAIT	MULLAHAJ				
		bëhet	DASHNOR	MALUSH	MALUSHI	297	8140	6/325	28.7
			ASQERIM	AVDYL	SADIKU				
63	Tirana 2	ishte	VJOLLCA	HYSEN	HALILI	1759	8120	5/417	43.23
			BAJRAM	ORHAN	DURO				
		bëhet	FARUK	AHMET	KURUSHI	1759	8120	5/418	26.62
			ARIANTHI	PIRO	BAJRAMAJ				
		bëhet	FATIME	NASUF	HALILI	1759	8120	5/418	68.82
			EDLIRA	VALTER	STAVRO				
64	Vlora	ishte	PATOS	NASIP	KERRAJ	703/1	8601	33/405	300
		bëhet							ANULOHET
LIDHJA AE									
65	Tirana 2	ishte	ARBEN	SELMAN	HARESHKA	20	8140	5/850	113.9
			LULËZIM	MUSTAFA	AGO				
		bëhet	ILIR	QEMAL	SHKEMBI	20	8140	5/850	113.9
			DRITA	IMER	DISTAFA				
		bëhet	SULO	XHEVIT	HODO	20	8140	5/850	113.9
			BUJAR	HAMDI	FARUKU				
		bëhet	ARBEN	SELMAN	HARESHKA	20	8140	5/850	113.9
			FIKE	MERSIN	AGO				
		bëhet	ILIR	QEMAL	SHKEMBI	20	8140	5/850	113.9
			DRITA	IMER	DISTAFA				
		bëhet	SULO	XHEVIT	HODO	20	8140	5/850	113.9
			BUJAR	HAMDI	FARUKU				
LIDHJA AG									
66	Kukes	ishte	ZEQIR	ZENEL	DUSHAJ	46	1347	4/192	6.27
			NEXHMIE	REXHË	GOÇI				
		bëhet	XHELADIN	SHABAN	DEZHLANI	46	1347	4/192	6.27
			ZEQIR	ZENEL	DUSHAJ				
		bëhet	NEXHMIE	REXHË	GOÇI	46	1347	4/192	6.27
			XHELADIN	SHABAN	DEZHLANI				



67	Kukes	ishte	KUJTIM	HALIL	OSMANAJ	395	1347	6/83	26.78
			JAH	SALI	ZENELAJ	140			
			SAHIT	REXHEP	DANAJ	140			
			VERA	REXHEP	ALIAJ	78			
			ABEDIN	SHPEND	SHIQUERUKAJ	78			
		FLUTURA	BAJRAM	PRELAJ	100				
		bëhet	JAH	SALI	ZENELAJ	140	1347	6/83	26.78
			SAHIT	REXHEP	DANAJ	140			
			VERA	REXHEP	ALIAJ	78			
			NAZMI	HAXHI	MADANI	78			
FLUTURA	BAJRAM		PRELAJ	100					
<b>LIDHJA AH</b>									
68	Kukes	ishte	ESAT	SADRI	KAMBERAJ	2	2431	1/12	300
		bëhet	ANULOHET						
<b>LIDHJA AJ</b>									
69	Tirana 2	ishte	ARJAN	SULEJMAN	SULA	17	8140	5/324	51.00
			BESNIK	AVDI	BREGU				
			LAVDIM	DEMIR	ÇIONIKU				
			KAMBER	ABDULLA	QORDJA				
			BASHKIM	XHEVAT	ÇADRI				
		bëhet	ARJAN	SULEJMAN	SULA	17	8140	5/324	51.00
			BESNIK	AVDI	BREGU				
			LAVDIM	DEMIR	ÇIONIKU				
			KAMBER	ABDULLA	QORDJA				
			RAMAZAN	MEHMET	ÇADRI				
<b>LIDHJA AK</b>									
70	Tirana 1	ishte	EDMOND	BESIM	MUÇA	732	8230	7/272	40.8
		bëhet	EDMOND	BESIM	MUÇA	732			

**VENDIM**

Nr. 741, datë 9.9.2015

**PËR MIRATIMIN E FORMËS, RASTEVE  
TË KTHIMIT DHE MËNYRËS SË  
LLOGARITJES TË GARANCIVE  
FINANCIARE PËR REHABILITIMIN E  
MJEDISIT, PËR REALIZIMIN E  
PROGRAMIT MINIMAL TË PUNËS DHE  
REALIZIMIN E INVESTIMIT NË  
VEPRIMTARINË MINERARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 31, të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:****I. GARANCIA FINANCIARE PËR REHABILITIMIN E MJEDISIT**

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), në cilësinë e strukturës përgjegjëse, gjatë procesit të vlerësimit të planit të rehabilitimit përfundimtar dhe progresiv të mjedisit për lejet e kërkim-zbulimit, përcakton vlerën monetare të garancisë financiare të detyrueshme, të përgjithshme e vjetore, për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit. Vlera monetare vjetore e garancisë financiare llogaritet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të viteve të

vlefshmërisë së lejes minerare dhe të sasisë së punimeve gjeologjike të programuara për t'u kryer çdo vit. Kjo vlerë përcaktohet në vendimin e këshillit teknik të SHGJSH-së dhe miratohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare (ministri).

2. Vlera e përgjithshme e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit për lejet e kërkim-zbulimit llogaritet si vlera monetare për financimin e aktiviteteve për realizimin e veprimtarive të mbylljes së punimeve gjeologjike të kërkim-zbulimit, të rehabilitimit progresiv e të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit të zonës së lejuar minerare dhe të asaj të përdorur nga subjekti për zhvillimin e veprimtarisë minerare.

3. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), në cilësinë e strukturës përgjegjëse, gjatë procesit të vlerësimit të planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit, përcakton vlerën monetare të garancisë financiare të detyrueshme, të përgjithshme e vjetore, për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit. Vlera monetare vjetore e garancisë financiare llogaritet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të viteve të vlefshmërisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit. Kjo vlerë përcaktohet në vendimin e këshillit teknik të AKBN-së dhe miratohet nga ministri.



4. Vlera e përgjithshme e garancisë financiare për rehabilitimin përfundimtar të mjedisit për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit llogaritet si vlera monetare për financimin e aktiviteteve për realizimin e veprimtarive të mbylljes së minierës dhe/ose karrierës, mbylljes dhe rehabilitimit të sheshit të depozitimit të mbetjeve, rehabilitimit progresiv e rehabilitimit përfundimtar të mjedisit të zonës së lejuar minerare dhe të asaj të përdorur nga subjekti për zhvillimin e veprimtarisë minerare.

5. Subjektet minerare hartojnë planin e rehabilitimit të mjedisit, sipas formatit standard, të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për mjedisin.

6. Vlera monetare e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit për lejet minerare, sipas pikave 1 e 3, të kreut I, të këtij vendimi, për vitin e parë, do të jetë e barabartë me vlerën e përgjithshme të garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, të ndarë me vitet e vlefshmërisë së lejes minerare të miratuar. Zotëruesi i lejes minerare dorëzon në QKL garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për vitin e parë, jo më vonë se 30 ditë nga data e njoftimit të vendimit të miratimit të lejes minerare.

7. Për vitin e dytë dhe në vazhdim, për lejet minerare të kërkim-zbulimit, vlera e garancisë rivlerësohet dhe përcaktohet nga SHGJSH-ja, në përputhje me sasinë e punimeve gjeologjike të parashikuara për t'u kryer në planin vjetor, nëse kjo sasi punimesh është më e madhe se sasia e programuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare. Dokumenti i garancisë financiare vjetore lëshohet në favor të ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, depozitohet në SHGJSH dhe në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, jo më vonë se 30 ditë kalendrike pas përfundimit të vitit paraardhës, i cili përlllogaritet duke filluar nga data efektive e marrjes së lejes minerare.

8. Për vitin e dytë dhe në vazhdim, për lejet minerare të shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit, vlera e garancisë rivlerësohet dhe përcaktohet nga AKBN-ja, në përputhje me sasinë e mineralit të parashikuar për t'u shfrytëzuar në planin vjetor, nëse kjo sasi është më e madhe se sasia e programuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare. Garancia financiare vjetore

depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, lëshohet në favor të ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare dhe dokumenti i garancisë depozitohet në AKBN dhe në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, jo më vonë se 20 ditë kalendrike pas përfundimit të vitit paraardhës, i cili përlllogaritet duke filluar nga data efektive e marrjes së lejes minerare.

9. Garancia financiare lëshohet nga një nga bankat e nivelit të dytë që vepron në Republikën e Shqipërisë, në favor të ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Për lejet minerare të dhëna sipas ligjit nr. 7796, datë 17.2.2004, “Ligji mineral i Shqipërisë”, zotëruesit e tyre do të paguajnë garancinë vjetore për rehabilitimin e mjedisit, sipas llogaritjeve të kryera nga AKBN-ja ose SHGJSH-ja.

11. Vlera e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit të lejeve minerare i kthehet zotëruesit të saj pas përfundimit të procesit të rehabilitimit progresiv ose përfundimtar të mjedisit. Verifikimi dhe kontrolli në terren i zbatimit të planit të rehabilitimit kryhet nga AKBN-ja, për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit, dhe nga SHGJSH-ja, për lejet e kërkim-zbulimit. Në grupin e punës që realizon verifikimin e zbatimit të planit të rehabilitimit të mjedisit përfshihen edhe specialistë të ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Plani i rehabilitimit konsiderohet i realizuar vetëm pas miratimit të raportit nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare. Pas miratimit të raportit, zotëruesit të lejes minerare i lirohet garancia financiare për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv ose përfundimtar të mjedisit.

12. Në rastet kur zotëruesi i lejes minerare nuk ka realizuar rehabilitimin progresiv ose përfundimtar, sipas planit të miratuar, ose në rast se zotëruesi i lejes minerare nënshkruan një marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, vlera e plotë e garancisë, vjetore apo e përgjithshme, e rehabilitimit të mjedisit, kalon në favor të shtetit.

13. Vlera e plotë e garancisë së rehabilitimit të mjedisit kalon në favor të shtetit në rastet kur zotëruesi i lejes minerare:

a) braktis veprimtarinë minerare, pa realizuar detyrimet e tij për rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit të zonës së lejuar



minerare, të përcaktuar në lejen minerare, kushtet specifike të saj dhe planin e rehabilitimit të zonës minerare;

b) braktis veprimtarinë minerare, pa realizuar detyrimet e tij për rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit të zonës së përdorur për veprimtari minerare jashtë zonës së lejuar minerare;

c) dështon, plotësisht ose pjesërisht, në kryerjen e rehabilitimit progresiv apo përfundimtar të sheshit të depozitimit të mbetjeve;

ç) dështon, plotësisht ose pjesërisht, në realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare;

d) dëmton, me qëllim dhe/ose në mënyrë aksidentale, mjedisin, gjatë realizimit të veprimtarisë së tij minerare;

dh) dëmton, me qëllim dhe/ose në mënyrë aksidentale, sheshin e depozitimit të mbetjeve minerare, gjatë realizimit të veprimtarisë së tij minerare;

e) nuk ka realizuar rehabilitimin përfundimtar, sipas planit të miratuar.

14. Vlera e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, e kaluar në favor të shtetit, përdoret nga ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare për rehabilitimin progresiv ose përfundimtar të mjedisit në zonën përkatëse ose, në raste të veçanta, në zonën përreth.

15. Ministria përgjegjëse, referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, zbaton procedurat standarde të prokurimit për përzgjedhjen e subjektit, i cili do të realizojë rehabilitimin e zonës përkatëse.

16. Garancitë ekzistuese financiare, të depozituara nga zotëruesit e lejeve ekzistuese minerare, do të jenë në fuqi për periudhën kohore të vitit për të cilën janë lëshuar. Pas kalimit të këtij afati, garancitë financiare për vitin në vazhdim do të lëshohen sipas kushteve dhe formatit të përcaktuar në aneksin 1, të këtij vendimi.

## II. GARANCIA FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MINIMAL TË PUNËS

1. Për lejet e kërkim-zbulimit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar vlerëson programin minimal të punës, i cili është pjesë e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare dhe përcakton, në vlerë monetare, garancinë financiare të detyrueshme, të përgjithshme e vjetore, për këtë program. Kjo vlerë e garancisë përcaktohet në vendimin e këshillit teknik të SHGJSH-së dhe miratohet nga ministri.

2. Vlera monetare e garancisë financiare për vitin e parë është e barabartë me vlerën e punimeve gjeologjike të miratuara, që, minimalisht, çdo zotërues i lejes minerare të kërkim-zbulimit realizon në këtë vit. Zotëruesi i lejes minerare dorëzon në QKL dhe në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare dokumentin e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës, jo më vonë se 30 ditë nga data e njoftimit të vendimit të miratimit të lejes.

3. Vlera monetare e garancisë financiare për vitin e dytë është e barabartë me vlerën e punimeve gjeologjike të miratuara, që, minimalisht, çdo zotërues i lejes minerare të kërkim-zbulimit realizon në këtë vit për vlerësimin e zonës së lejuar. Kjo garanci financiare vjetore depozitohet në SHGJSH dhe në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas përfundimit të vitit të llogaritur me datën efektive të marrjes së lejes minerare.

4. Garancia financiare lëshohet nga një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, në favor të ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Vlera e garancisë financiare vjetore, për zbatimin e programit minimal të punës së lejeve të kërkim-zbulimit, për vitin e parë, i kthehet zotëruesit të lejes minerare 60 ditë pas përfundimit të vitit, që përlllogaritet nga data efektive e marrjes së lejes minerare. Vlera e kthyer është në përputhje me shumën e shpenzuar nga zotëruesi i lejes minerare gjatë realizimit të programit të tij të punës gjatë këtij viti deri në vlerën e plotë të garancisë. Kthimi bëhet pas hartimit të raportit të detajuar nga SHGJSH-ja dhe miratimit nga ministri.

6. Vlera e garancisë financiare vjetore, për zbatimin e programit minimal të punës së lejeve kërkim-zbulimit, për vitin e dytë, i kthehet zotëruesit të lejes minerare 60 ditë pas përfundimit të vitit të dytë. Kur zotëruesi i lejes minerare, në përfundim të periudhës së vitit të dytë, ka dështuar për kryerjen, plotësisht ose pjesërisht, të programit minimal të punës, atëherë ai i paguan shtetit një vlerë monetare të barabartë me pjesën e paplotësuar të angazhimit financiar për programin minimal të punës që kryhet, duke kaluar në favor të shtetit pjesën e pakthyer të garancisë financiare për programin minimal të punës.





7. Garancitë ekzistuese financiare, të depozituara nga zotëruesit e lejeve ekzistuese minerare, do të jenë në fuqi për periudhën kohore të vitit për të cilën janë lëshuar. Pas kalimit të këtij afati, garancitë financiare për vitin në vazhdim lëshohen sipas kushteve dhe formatit të përcaktuar në aneksin 1, të këtij vendimi.

### III. GARANCIA FINANCIARE PËR REALIZIMIN E INVESTIMIT

1. Për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, gjatë procesit të vlerësimit të programit të investimit, që është pjesë e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare, llogarit, në vlerë monetare, garancinë financiare të detyrueshme për periudhën e investimit. Kjo vlerë përcaktohet në vendimin e këshillit teknik të AKBN-së për miratimin e planit të veprimtarisë minerare dhe miratohet nga ministri.

2. Garancia financiare për investimin kryhet vetëm një herë dhe vlera monetare e saj është 10% e vlerës së investimit vjetor, të parashikuar në projekt, që i korrespondon vitit për të cilin është parashikuar investimi maksimal. Zotëruesi i lejes e dorëzon garancinë financiare për realizimin e investimit në QKL dhe në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare brenda 20 ditëve kalendarike pas marrjes së lejes së shfrytëzimit.

3. Garancia financiare lëshohet nga një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, në favor të ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Zotëruesit e lejeve ekzistuese minerare janë të detyruar që, brenda datës 30 tetor 2015, të rinovojnë garancitë ekzistuese financiare, të lëshuara për lejet minerare që janë në periudhë investimi, si më poshtë vijon:

a) Në rast se garancia ekzistuese financiare është lëshuar për vlerën 10 % të vlerës së investimit të vitit të parashikuar në projekt, me investimin maksimal, zotëruesit e lejeve minerare janë të detyruar të rinovojnë vetëm afatin e vlefshmërisë së garancisë ekzistuese financiare, sipas të dhënave të afatit të vlefshmërisë të përcaktuar në formatin e garancisë financiare në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Në rast se garancia financiare ekzistuese është në vlerë më të vogël se vlera 10% e vlerës vjetore të parashikuar në projekt, për vitin me investim

maksimal, zotëruesi i lejes minerare është i detyruar që, në momentin e depozitimit dhe mbrojtjes së programit vjetor të radhës, të dorëzojë një garanci financiare shtesë, në vlerë të barabartë me diferencën e garancisë financiare të përlogaritur për vlerën e investimit vjetor, për vitin me investim maksimal, me vlerën e garancisë së paguar në vitin paraardhës, si dhe të rinovojë afatin e garancisë ekzistuese financiare sipas të dhënave të afatit të vlefshmërisë, të përcaktuara në formatin e garancisë financiare në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Në çdo rast, afati i vlefshmërisë së garancive financiare, ekzistuese apo të reja, duhet të jetë deri në 60 ditë nga data e përfundimit të periudhës së investimeve të parashikuara në projekt.

6. Me përfundimin e periudhës dhe realizimit të investimeve të parashikuar në projekt, zotëruesi i lejes minerare nuk bën pagesë për garanci financiare për investime. Këtë të drejtë e gëzojnë të gjithë zotëruesit e lejeve ekzistuese minerare që kanë përfunduar periudhën e investimeve.

7. Vlera e garancisë financiare për realizimin e investimit për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit i kthehet zotëruesit të lejes minerare në fund të periudhës së investimeve, të përcaktuar në programin e zhvillimit të veprimtarisë minerare, pas hartimit të raportit të detajuar të strukturës përgjegjëse në AKBN dhe miratimit nga ministri, në rastet kur:

a) investimi është realizuar brenda afatit dhe në masën 100% apo mbi 100% të vlerës së përgjithshme të parashikuar në projekt. Në këtë rast, zotëruesit të lejes minerare të shfrytëzimit i kthehet vlera e plotë e garancisë, brenda 90 ditëve nga data e përfundimit të periudhës së investimeve të parashikuara;

b) investimi është realizuar brenda afatit dhe në masën mbi 90% të vlerës së përgjithshme të investimit të parashikuar në projekt. Në këtë rast, vlera e kthimit të garancisë financiare, për zotëruesin e lejes minerare, do të jetë pjesore, e përlogaritur në përputhje me përqindjen e realizimit të investimeve. Pjesa e mbetur e garancisë, pas kthimit të pjesshëm që i bëhet zotëruesit të lejes minerare, kalon në favor të shtetit.

8. Kur zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit nuk ka realizuar investimin deri në 90% të vlerës së përgjithshme të investimeve dhe në afatin e parashikuar në projekt, vlera e plotë e garancisë



financiare të investimit kalon në favor të shtetit.

9. Pas përfundimit të rehabilitimit, zonës së lejuar minerare i rikthehet statusi i saj i mëparshëm.

10. Ngarkohet ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare dhe ministri përgjegjës për mjedisin, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimin përkatës, në zbatim të pikës 3, të kreut I, të këtij vendimi.

11. Vendimi nr. 440, datë 16.6.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formës, të kushteve të rikthimit dhe të mënyrës së llogaritjes së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe për realizimin e investimit”, shfuqizohet.

12. Ngarkohet ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

ANEKSI 1  
FORMULARI I GARANCISË BANKARE  
PËR REALIZIMIN E PLANIT TË  
REHABILITIMIT TË MJEDISIT  
(Për çdo leje minerare)

Nr. ref. \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

Me këtë dokument vërtetojmë se (emri i zotëruesit të lejes minerare) ka derdhur pranë (emri i bankës, adresa) shumën prej (shuma në shifra dhe fjalë), si garanci bankare, të lëshuar në favor të (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare), për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për vitin (viti që mbulon garancia), për lejen minerare nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, (tipi i lejes) për mineralin e (emri i mineralit/mineraleve), për objektin minerar (vendin ku ndodhet zona e lejuar minerare).

Banka merr përsipër, pa kërkuar shpjegime, të kalojë në llogarinë e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare) këtë garanci bankare, në rast se:

1. zotëruesi i lejes minerare braktis veprimtarinë minerare pa realizuar detyrimet e tij për rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit të zonës së lejuar minerare, të përcaktuar në lejen minerare, kushtet specifike të saj dhe planin e rehabilitimit të zonës minerare;

2. zotëruesi i lejes minerare braktis veprimtarinë minerare pa realizuar detyrimet e tij për rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit të zonës së përdorur për veprimtari minerare jashtë zonës së lejuar minerare;

3. zotëruesi i lejes minerare dështon, plotësisht ose pjesërisht, në kryerjen e rehabilitimit progresiv apo përfundimtar të sheshit të depozitimit të mbetjeve;

4. zotëruesi i lejes minerare dështon, plotësisht ose pjesërisht, në realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare;

5. zotëruesi i lejes minerare dëmton me qëllim dhe/ose në mënyrë aksidentale mjedisin gjatë realizimit të veprimtarisë së tij minerare;

6. zotëruesi i lejes minerare dëmton me qëllim dhe/ose në mënyrë aksidentale sheshin e depozitimit të mbetjeve minerare gjatë realizimit të veprimtarisë së tij minerare;

7. zotëruesi i lejes minerare nuk ka realizuar rehabilitimin përfundimtar, sipas planit të miratuar.

Kalimi i garancisë në llogarinë e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare) do të bëhet nga banka menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesës së parë me shkrim nga ana e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare), pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i detyrimit që ka të bëjë me një prej rasteve të mësipërme.

Në rastet kur zotëruesi i lejes minerare ka realizuar programin progresiv apo përfundimtar të rehabilitimit të mjedisit, me miratimin e ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare, garancia financiare lirohet, për llogari të zotëruesit të lejes minerare.

Kjo garanci është e vlefshme deri në 60 ditë nga përfundimi i afatit të përgjithshëm të lejes minerare (afati i garancisë sipas jetëgjatësisë së lejes minerare).

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi dhe vula e bankës

FATURË PËR ARKËTIM TË GARANCISË  
FINANCIARE TË REHABILITIMIT TË  
MJEDISIT PËR VITIN...

BANKËS \_\_\_\_\_

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka juaj të pranojë nga klientë (persona/persona fizik/persona juridikë) arkëtime, për llogari të institucionit tonë,



me emërimet, kodet dhe shumat si më poshtë:  
 Emri i institucionit përfitues: Ministria e Energjisë  
 dhe Industrisë  
 Kodi i institucionit: 1093001  
 Kodi i degës së thesarit ku vepron: 3535  
 Emri i paguesit \_\_\_\_\_  
 Numri i identifikimit të paguesit \_\_\_\_\_

ID e detyrimit	PËRSHKRIMI I GARANCISË FINANCIARE		Shuma që arkëtohet (lekë)
	Emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	
_____	Vlera e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin _____, të lejes minerare shfrytëzimit/kërkim zbulimit /etj nr. _____ datë _____	4662103	_____
	SUBJEKTI		
	Shuma		

INSTITUCIONI  
 Përfaqësuesi i institucionit juridik  
 (Emër, mbiemër, nënshkrim)

KLIENTI  
 (Person/personi fizik/person  
 (Emër, mbiemër, nënshkrim)  
 Adresa: \_\_\_\_\_  
 Kontakti: \_\_\_\_\_

## ANEKSI 2

### FORMULARI I GARANCISË BANKARE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MINIMAL TË PUNËS

(Për lejet minerare të kërkim-zbulimit)

Me këtë dokument vërtetojmë se (emri i zotëruesit të lejes minerare) ka derdhur pranë (emri i bankës, adresa) shumën prej (shuma në shifra dhe fjalë), si garanci bankare të lëshuar në favor të (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare), për realizimin e programit minimal të punës për vitin (viti që mbulon garancia) për lejen minerare të kërkim-zbulimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, për mineralin e (emri i mineralit/mineraleve) për objektin minerar (vendin ku ndodhet zona e lejuar minerare).

Banka merr përsipër, pa kërkuar shpjegime, të kalojë në llogarinë e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare) këtë garanci bankare, në rast se zotëruesi i lejes minerare dështon për

realizimin, plotësisht ose pjesërisht, të programit minimal të punës për lejen e tij minerare të kërkim-zbulimit.

Kalimi i garancisë në llogarinë e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare) do të bëhet nga banka menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë kalendrike nga paraqitja e kërkesës së parë me shkrim nga ana e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare), pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i detyrimit që ka të bëjë me rastin e mësipërm.

Në rastet kur zotëruesi i lejes minerare ka realizuar pjesërisht ose plotësisht programin minimal të punës, me miratimin e ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare, garancia financiare lirohet, për llogari të zotëruesit të lejes minerare.

Kjo garanci është e vlefshme deri në 60 ditë nga përfundimi i afatit të realizimit të programit minimal të punës (afati i garancisë sipas afatit të realizimit të programit minimal të punës).

\_\_\_\_\_  
 Nënshkrimi dhe vula e bankës

### FATURË PËR ARKËTIM TË GARANCISË FINANCIARE TË INVESTIMIT REALIZIMIN E PROGRAMIT MINIMAL TË PUNËS PËR VITIN

(Për lejet minerare të kërkim-zbulimit)  
 BANKËS \_\_\_\_\_

Me anë të kësaj faturë kërkojmë që banka juaj të pranojë nga klientë (persona/ persona fizikë /persona juridikë) arkëtime, për llogari të institucionit tonë, me emërimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i institucionit përfitues : Min. Energjisë dhe Industrisë

Kodi i institucionit: 1093001

Kodi i degës së thesarit ku vepron: 3535

Emri i paguesit \_\_\_\_\_

Numri i identifikimit të paguesit, \_\_\_\_\_

ID e detyrimit	PËRSHKRIMI I GARANCISË FINANCIARE		Shuma që arkëtohet (lekë)
	Emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	
_____	Vlera e garancisë financiare të realizimit të programit minimal	4662103	_____



	të punës për lejen minerare kërkim zbulimit, Nr. _____ datë _____		
	SUBJEKTI		
	Shuma		

## INSTITUCIONI

Përfaqësuesi i institucionit juridik  
(Emër, mbiemër, nënshkrim)

## KLIENTI

(Person/personi fizik/person  
(Emër, mbiemër, nënshkrim)

Adresa: \_\_\_\_\_

Kontakti: \_\_\_\_\_

## ANEKSI 3

### FORMULARI I GARANCISË BANKARE PËR REALIZIMIN E INVESTIMIT

(Për lejet minerare të shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit)

Me këtë dokument vërtetojmë se (emri i zotëruesit të lejes minerare) ka derdhur pranë (emri i bankës, adresa) shumën prej (shuma në shifra dhe fjalë), si garanci bankare të lëshuar në favor të (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare), për realizimin e programit të investimit për vitin (viti që mbulon garancia), për lejen minerare të shfrytëzimit dhe/ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, për mineralin e (emri i mineralit/mineraleve) për objektin minerar (vendin ku ndodhet zona e lejuar minerare).

Banka merr përsipër, pa kërkuar shpjegime, të kalojë në llogarinë e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare) këtë garanci bankare në rast se zotëruesi i lejes minerare dështon për realizimin, plotësisht ose pjesërisht, të programit të investimit për lejen e tij minerare të shfrytëzimit dhe/ose të kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

Kalimi i garancisë në llogarinë e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare) do të bëhet nga banka menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë kalendrike nga paraqitja e kërkesës së parë me shkrim nga ana e (emrin e ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare), pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i detyrimit që ka të bëjë me rastin e mësipërm.

Në rastet kur subjekti ka realizuar investimet sipas programit dhe, bazuar në kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi, me miratimin

e ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare, garancia financiare lirohet për llogari të zotëruesit të lejes minerare.

Kjo garanci është e vlefshme deri në 60 ditë nga data e përfundimit të periudhës së investimeve.

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi dhe vula e bankës

## FATURË PËR ARKËTIM

### FORMULARI I GARANCISË FINANCIARE PËR REALIZIMIN E INVESTIMIT PËR VITIN \_\_\_\_\_

(Për lejet minerare të shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit)

BANKËS \_\_\_\_\_

Me anë të kësaj faturë kërkojmë që Banka Juaj të pranojë nga klientë (persona/persona fizikë) persona juridikë) arkëtime, për llogari të institucionit tonë, me emërimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i institucionit përfitues: Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Kodi i institucionit: 1093001

Kodi i degës së thesarit ku vepron: 3535

Emri i paguesit \_\_\_\_\_

Numri i identifikimit të paguesit \_\_\_\_\_

ID e detyrimit	PËRSHKRIMI I GARANCISË FINANCIARE		Shuma që arkëtohet (lekë)
	Emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	
_____	Vlera e garancisë financiare të realizimit të programit minimal të punës për lejen minerare kërkim zbulimit, Nr. _____ datë _____	4662103	_____
	SUBJEKTI		
	Shuma		

## INSTITUCIONI

Përfaqësuesi i institucionit juridik  
(Emër, mbiemër, nënshkrim)

## KLIENTI

(Person/personi fizik/person  
(Emër, mbiemër, nënshkrim)

Adresa: \_\_\_\_\_

Kontakti: \_\_\_\_\_



**VENDIM**  
**Nr. 743, datë 9.9.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN**  
**NR. 456, DATË 27.5.2015, TË KËSHILLIT**  
**TË MINISTRAVE, “PËR**  
**SHPRONËSIMIN, PËR INTERES**  
**PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE**  
**TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,**  
**QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT**  
**“REHABILITIMI I AMFITEATRIT TË**  
**DURRËSIT”“**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 456, datë 27.5.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK, TË CILAT PREKEN NGA “PROJEKTI PËR REHABILITIMIN E HAPËSIRËS SË AMFITEATRIT TË DURRËSIT”

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe ( m2)		Çmimi lekë/m <sup>2</sup>		Vlera lekë		SHËNIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Banese	
1	Skënder MYSHKETA	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	Sipas kartelës së pasurisë
2	Naxhie BYLYKBASHI	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	Sipas kartelës së pasurisë
3	Lutfic QOSJA	8512	24/619	56.133	51.03	17,898	70,093	1,004,674	3,576,845.79	Sipas kartelës së pasurisë
4	Myrteza ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
5	Zyra BLLACA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
6	Besnik ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
7	Shekibe ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
8	Fatmir ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
9	Shpresa BASHA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
10	Abdulla ZAZA	8512	24/618	24.0	23.714	17,898	70,093	429,552	1,662,205.43	Sipas kartelës së pasurisë
				<b>336.40</b>	<b>319.1</b>			<b>6,020,887</b>	<b>22,365,975</b>	<b>28,386,863</b>
				<b>TOTALI : 28,386,863 lekë</b>						

a) Kudo në përmbajtjen e vendimit dhe në listën bashkëlidhur, vlera “...25 379 999 (njëzet e pesë milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë ...” zëvendësohet me “...28 386 863 (njëzet e tetë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë...”.

b) Në shkronjën “b”, të pikës 4, vlera “...11 379 999 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë...” zëvendësohet me “...14 386 863 (katërmëdhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë...”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministra e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



**UDHËZIM**  
**Nr. 22/1, datë 17.9.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN**  
**NR. 22, DATË 31.7.2015 “MBI**  
**PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË**  
**SHËRBIMIT PËR QARKULLIMIN E**  
**MJETEVE TË HUAJA TË TRANSPORTIT**  
**TË UDHËTARËVE, TË MË SHUMË SE 20**  
**PERSONAVE, PËRFSHIRË EDHE**  
**DREJTUESIN E MJETIT, SI DHE TË**  
**MJETEVE TË TRANSPORTIT TË**  
**MALLRAVE ME NGARKESË APO PA**  
**NGARKESË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Pikat 5, 6 dhe 7 të udhëzimit ndryshojnë me këtë përmbajtje:

“5. Drejtuesi i mjetit, në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjete me targë të huaj, kryen pagesën e tarifës së përcaktuar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

6. Kjo pagesë bëhet me mandat arkëtimi. Dy kopje të mandatarëkëtimit i jepen drejtuesit të mjetit, ndërsa kopja e tretë ruhet në degën doganore hyrëse. Drejtuesi i mjetit, një kopje të mandatit e dorëzon në doganën e destinacionit dhe një kopje e mban për vetë.

7. Shumat e tarifave të arkëtuara në degët doganore kufitare regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas formularit nr. 1 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi”.

2. Formularët nr. 1 dhe nr. 2 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi shfuqizohen dhe zëvendësohen me formularin nr. 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Në pikën 8, germa c), kudo në përmbajtje togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave” zëvendësohet me “Degët doganore”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Shkëlqim Cani**

Formulari nr. 1

**REGJISTRI DITOR I TARIFËS SË QARKULLIMIT**  
**TË AUTOMJETEVE TË HUAJA**

Nr.	Lloji i mjetit /Targa	Emri i zotëruesit /i drejtuesit të mjetit	Shteti nga vjen mjete	Data e hyrjes në RSH	Nr. dhe data e doku mentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar

**URDHËR**

**Nr. 36, datë 12.5.2015**

**PËR KUFIZIMIN E SASIVE TË**  
**KARBURANTIT QË GJENDET NË**  
**SERBATORËT E ZAKONSHËM DHE**  
**DEPOZITAT E POSAÇME TË**  
**AUTOMJETEVE TREGTARE DHE NË**  
**SERBATORËT E LËVIZSHËM TË**  
**AUTOMJETEVE PRIVATE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shkronjës “t”, të pikës 3, të nenit 184, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të neneve 207, 208, 209, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 919, datë 29.12.2014, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit, nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

**URDHËROJ:**

1. Përfshihet nga detyrimet e importit, karburanti që mbajnë serbatorët e zakonshëm dhe depozitat e posaçme të automjeteve tregtare, vetëm për sasinë deri në 200 litra për automjet dhe për çdo udhëtim.

2. Përfshihet nga detyrimet e importit, karburanti që mbajnë serbatorët e zakonshëm dhe depozitat e posaçme të automjeteve tregtare, që kryejnë transport ndërkombëtar nëpër zonën e tyre kufitare me thellësi maksimale prej 15 km në vijë ajrore, me kusht që udhëtimet të kryhen nga banues të zonës kufitare, vetëm për sasinë deri në 150 litra për automjet dhe për çdo udhëtim.

3. Nuk lejohet përjashtim nga detyrimet e importit për karburantin që mbahet në serbatorë të lëvizshëm, që transportohet nga automjete private dhe motoçikleta që u përkasin banuesve të zonës kufitare.



4. Në rast të konstatimit nga administrata doganore të tejkalimit të sasive të karburantit sipas përcaktimeve në këtë urdhër, ndaj subjektit /individit zbatohen të gjitha detyrimet e importit, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën kur ndodhi mosrespektimi. Llojit të mallrave dhe të vlerës doganore të konstatuar ose pranuar prej autoriteteve doganore kompetente në atë datë.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet strukturave të saj për zbatimin korrekt të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Shkëlqim Cani**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës”Shqipëria Sot”,  
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë